



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

**Raport për rezultatet e konsultimit publik
për projektvendimin:**

“Për miratimin e listës së veprimtarive që konsiderohen si të rrezikshme për mjedisin”.

1. Titulli i projekt aktit

Projektvendimi “Për miratimin e listës së veprimtarive që konsiderohen si të rrezikshme për mjedisin”.

Ky projektvendim ka për qëllim miratimin e listës së veprimtarive që konsiderohen si të rrezikshme për mjedisin, me synim identifikimin, monitorimin dhe administrimin e veprimtarive që paraqesin rrezik të lartë për shkaktimin e dëmit mjedisor dhe sjellin përgjegjësi mjedisore sipas legjislacionit në fuqi.

Gjithashtu, ky projektvendim garanton një qasjeje të unifikuar në vlerësimin e këtyre veprimtarive nga strukturat përgjegjëse në fushën e mjedisit dhe krijimin e bazës për zbatimin e masave parandaluese dhe përgjegjësi përkatëse nga operatorët.

Projektvendimi synon:

- Identifikimin e veprimtarive që paraqesin rrezik të shtuar për mjedisin;
- Parandalimin e dëmit mjedisor, duke orientuar ndërhyrjen e hershme dhe marrjen e masave mbrojtëse për këto veprimtari;

- Forcimin e përgjegjësisë së operatorëve, përmes përcaktimit të qartë të subjekteve që i nënshtrohen detyrimeve të posaçme ligjore;
- Lehtësimin e zbatimit të legjislacionit mjedisor, veçanërisht në kuadër të përgjegjësisë për dëmin mjedisor dhe masave parandaluese/korrigjuese;
- Sigurimin e një kuadri ligjor/nënligjor të qartë për autoritetet kompetente në fushën e mjedisit, për monitorimin, kontrollin dhe marrjen e vendimeve administrative në lidhje me këto veprimtari.
- Harmonizimin e legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian në fushën e përgjegjësisë mjedisore.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Kohëzgjatja e konsultimit publik për këtë akt ishte 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik.

Projektvendimi “Për miratimin e listës së veprimtarive që konsiderohen si të rrezikshme për mjedisin” i është nënshtuar procesit të konsultimit publik nëpërmjet publikimit në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik (RENJKP), nga data 4.6.2026 deri në datë 2.7.2026.

3. Metodat e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të projektvendimit, ishin:

1. Publikimi në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik (RENJKP),

2. Dëgjese publike në ambjentet e Ministrisë së Mjedisit, që u zhvillua në datën 12.6.2026, në orën 12:00.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Mjedisit dhe i është dërguar për mendim, nëpërmjet sistemit e-akte: Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator.

Palët e interesit të përfshira në procesin e konsultimit publik janë Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri – FIAA dhe INCA - në cilësinë e operatorit të licencuar në fushën e grumbullimit, transportit, trajtimit dhe asgjësimit të nënprodukteve shtazore dhe produkteve me origjinë shtazore të papërshtatshme për konsum human të cilët kanë bërë pyetje dhe komente lidhur me projektaktin.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Projektvendimi pati 351 shikime në (RENJKP) dhe disa pyetje e komente, të cilat paraqiten më poshtë:

Në total janë paraqitur 10 pyetje dhe komente, nga të cilat 7 (shtatë) janë pyetje që lidhen me projektvendimin dhe për nga natyra e tyre, nuk kërkojnë pranim apo refuzim, ndërsa 3 (tre) janë komente/sugjerime, të cilat janë refuzuar.

Refuzimi i komenteve ka ndodhur për shkak se ato nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin dhe fushën e rregullimit të projektvendimit dhe për rrjedhojë, nuk mund të reflektohen në përmbajtjen e tij.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/I	Justifikimi
--------------------	---------	---------------------	----------------------	-------------

			pranuar pjesërisht/I refuzuar)	
Hartimi i projektvendimit “Për miratimin e listës së veprimtarive që konsiderohen si të rrezikshme për mjedisin”.	Kush e përcakton nëse operatori i biznesit është në listën e veprimtarive që konsiderohen të rrezikshme, Ministria, AKM, vet operatori?	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri - FIAA	Nuk është koment që ka nevojë të pranohet apo refuzohet, por pyetje rreth projektvendimit.	Projektvendimi nuk parashikon një procedurë individuale klasifikimi nga Ministria apo AKM-ja. Një operator konsiderohet se ushtron një veprimtari të rrezikshme kur aktiviteti që ai zhvillon përfshihet në kategoritë e përcaktuara në Shtojcën 1 të vendimit. AKM-ja, si autoritet përgjegjës për zbatimin e vendimit, në konsultime

				operatorin vlerëson rast pas rasti nëse veprimtaria konkrete e operatorit hyn në një nga kategoritë e listuara, duke u mbështetur në lejet, autorizimet dhe dokumentacionin përkatës të operatorit. Konsultimi me operatorin mund të kryhet gjatë procesit të verifikimit të fakteve dhe dokumentacionit.
	Cilat janë efektet juridike dhe administrative të përfshirjes së një operatori në këtë listë?	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri - FIAA	Nuk është koment që ka nevojë të pranohet apo refuzohet, por pyetje rreth	Përfshirja në listë nuk krijon automatikisht një detyrim për pajisje me autorizim apo leje të

			projektvend imit	re. Efekti kryesor juridik është se, në rast të shkaktimit të dëmit mjedisor ose të ekzistencës së një kërcënimi të afërt për dëmtim mjedisor, operatori i nënshtrohet detyrimit të përgjegjësisë mjedisore sipas nenit 50 të ligjit nr. 10431/2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". Kjo nënkupton detyrimin për marrjen e masave parandaluese, korrigjuese dhe rehabilituese, si dhe për mbulimin e kostove përkatëse
--	--	--	---------------------	---

				sipas parimit "Ndotësi Pagan" dhe në bazë të VKM-së “Për Miratimin e Kritereve në Bazë të të cilave bëhet Vlerësimi i Kërcënimit të Mundshëm dhe Përcaktimi i Dëmit në Mjedis”.
	A sjell kjo detyrime shtesë, monitorim shtesë, përgjegjësi shtesë apo procedura të reja?	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri - FIAA	Nuk është koment që ka nevojë të pranohet apo refuzohet, por pyetje rreth projektvendimit.	Projektvendimi nuk krijon detyrime të reja operacional e, procedura të reja lejeje apo monitorimi të veçantë për operatorët. Ai shërben për identifikimin e veprimtarive ndaj të cilave zbatohet

				kuadri i përgjegjës is ë mjedisore sipas legjislacionit në fuqi. Detyrimet konkrete lindin vetëm në rastin e kërcënimit të afërt të dëmit mjedisor ose kur dëmi mjedisor është shkaktuar.
	Si do të përcaktohet në praktikë nëse një veprimtari konsiderohet "e rrezikshme" nëse nuk është e përfshirë në listë?	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri - FIAA	Nuk është koment që ka nevojë të pranohet apo refuzohet, por pyetje rreth projektvendimit.	Vetë projektvendimi parashikon shprehimisht se lista ka karakter orientues dhe jo shterues. Kjo do të thotë se edhe veprimtari të tjera mund të konsiderohen të rrezikshme kur, për

				shkak të natyrës së tyre, teknologjisë së përdorur, përmasave të aktivitetit ose substancave të përdorura, paraqesin rrezik të lartë për dëme mjedisore. Vlerësimi do të bëhet rast pas rasti nga autoritetet kompetente, duke u bazuar në karakteristikat konkrete të aktivitetit si dhe në bazë të dëmit të shaktuar.
	A do të kete kritere objektive apo kjo do të mbetet në diskrecion të administratës?	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri - FIAA	Nuk është koment që ka nevojë të pranohet apo refuzohet, por pyetje rreth	Vlerësimi nuk mbështetet në diskrecion të administratës. Projektvend

			projektvend imit.	imi përcakton kritere objektive, si: • natyr a e veprimtaris ë; • niveli i rrezikut ndaj burimeve natyrore; • përm asatë aktivitetit; • tekno logjia e përdorur; • subst ancat e përdorura ose të shkarkuara në mjedis; • poten ciali për të dëmtuar ujërat, tokën, ajrin, biodiversite tin dhe shëndetin e njeriut.
--	--	--	------------------------------	--

	A do të ketë një qasje të bazuar në nivelin real të riskut dhe madhësinë e aktivitetit, apo të gjitha veprimtaritë e listuara do të trajtohen në të njëjtën mënyrë?	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri - FIAA	Nuk është koment që ka nevojë të pranohet apo refuzohet, por pyetje rreth projektve vendimit.	Po. Regjimi i përgjegjësisë mjedisore është i lidhur me nivelin real të riskut dhe me dëmin ose kërcënimin konkret që mund të shkaktojë një aktivitet. Fakti që një veprimtari është e përfshirë në listë nuk do të thotë se të gjithë operatorët trajtohen në mënyrë identike. Masat parandaluese, korrigjuese dhe rehabilituese do të përcaktohen në përpjesëtim me natyrën, përmasën dhe
--	--	---	--	--

				ndikimin konkret të rastit të evidentuar.
	A klasifikohen automatikisht si "veprimtari të rrezikshme" të gjithë operatorët që kanë leje shkarkimi, edhe kur shkarkimet janë plotësisht në përputhje me kushtet e lejes?	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri - FIAA	Nuk është koment që ka nevojë të pranohet apo refuzohet, por pyetje rreth projektvendimit.	Po, sipas Shtojcës 1 të projektvendimit, në kategorinë e veprimtariv e të rrezikshme përfshihen instalimet dhe veprimtaritë që pajisen me leje për shkarkimet në ujërat sipërfaqësor e ose nëntokësore . Megjithatë, përfshirja në listë nuk nënkupton automatikisht shkelje ose përgjegjësi. Përkundrazi , ajo vetëm përcakton se këto veprimtari bëjnë pjesë

				në kategoritë, për të cilat mund të zbatohet kuadri i përgjegjësisë mjedisore nëse shkaktohet dëm mjedisor ose ekziston kërcënim i mundshëm i tij. Fakti që operatori vepron në përputhje me kushtet e lejes mbetet një element i rëndësishëm për vlerësimin e përgjegjësisë sipas ligjit.
Pika 2. “që pajisen me leje mjedisi në zbatim të legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit dhe për menaxhimin e mbetjeve”.	Të shtohen referenca të qarta ndaj VKM-ve ku përcaktohen aktivitetet e listuara për të shmangur interpretimet.	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri – FIAA	Refuzuar	Për pikat ku komentohet që të shtohen referenca të qarta të legjislacionit në fuqi për të shmangur interpretimet, sqarojmë

Pika 3. “që pajisen me leje për shkarkimet e lëngshme në trupat ujqorë sipërfaqësorë referuar legjislacionit në fuqi për burimet ujore dhe legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit”.				se lista e veprimtariv e është hartuar për të reflektuar kategoritë e veprimtariv e të Aneksit III të Direktivës 2004/35/EC për përgjegjësin e mjedisore. Nëse përfshihen referenca të detajuara ndaj të gjitha VKM-ve sektoriale, ekziston rreziku që çdo ndryshim i mëvonshëm i këtyre akteve të kërkojë edhe ndryshimin e projektvendimit. Për mëtejse që jemi në proces integrimi dhe aktet
--	--	--	--	--

				ligjore janë në procedura amendimi të vazhduesh me. Gjithashtu mund të kufizohet karakteri i përgjithshëm i listës.
Pika 7 Çdo veprimtari industriale, tregtare ose bujqësore që lidhet dhe përfshin prodhimin, përdorimin, ruajtjen,	Rekomandohet të vendosen qartë pragjet sasiore për përshtirjen e instalimeve. Formulimi aktual nuk referon pragje dhe mund të interpretohet si përfshirje e çdo aktiviteti që përdor substanca kimike apo substanca të rrezikshme. Duhet të bëhet dallim i qartë midis përdorimit të zakonshëm të substancave kimike në procese industriale dhe aktivitete që përfshijnë magazinimin ose përdorim në shkallë të lartë industriale të substancave të	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri - FIAA	Refuzuar	Projektvendi nuk ka për objekt përcaktimin e pragjeve sasiore apo klasifikimin teknik të substancave të rrezikshme, pasi këto elemente rregullohen nga legjislacioni sektorial përkatës. Qëllimi i aktit është identifikimi i kategorive të veprimtarive që konsiderohen të rrezikshme

	klasifikuara si të rrezikshme.			për efekt të zbatimit të përgjegjësisë për dëmin mjedisor, në përputhje me Shtojcën III të Direktivës 2004/35/EC . Përfshirja e pragjeve të veçanta në këtë akt do të krijonte mbivendosje dhe mundësi mospërputhjeje me legjislacionin sektorial në fuqi.
“sipas legjislacionit në fuqi për kimikatet”	Të shtohen referenca të qarta të legjislacionit në fuqi për të shmangur interpretimet.	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri - FIAA		Për pikat e mësipërme ku komentohet që të shtohen referenca të qarta të legjislacionit në fuqi për të shmangur interpretimet, sqarojmë se lista e veprimtarive është

				hartuar për të reflektuar kategoritë e veprimtariv e të Aneksit III të Direktivës 2004/35/EC për përgjegjësin e mjedisore. Nëse përfshihen referenca të detajuara ndaj të gjitha VKM-ve sektoriale, ekziston rreziku që çdo ndryshim i mëvonshëm i këtyre akteve të kërkojë edhe ndryshimin e projektvendimit. Për mëtej për që jemi në proces integrimi dhe aktet ligjore janë në procedura
--	--	--	--	---

				amendimi të vazhduesh me. Gjithashtu mund të kufizohet karakteri i përgjithshëm i listës.
Pika 9. “zbatim të legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit, si dhe aktet nënligjore përkatëse në lidhje me shkarkimin në ajër të substancave ndotëse”.	Të shtohen referenca të qarta të legjislacionit në fuqi për të shmangur interpretimet.	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri - FIAA		Për pikat ku komentohet që të shtohen referenca të qarta të legjislacionit në fuqi për të shmangur interpretimet, sqarojmë se lista e veprimtarive është hartuar për të reflektuar kategoritë e veprimtarive të Aneksit III të Direktivës 2004/35/EC për përgjegjësinë mjedisore. Nëse përfshihen referenca të detajuara ndaj të gjitha

				VKM-ve sektoriale, ekziston rreziku që çdo ndryshim i mëvonshëm i këtyre akteve të kërkojë edhe ndryshimin e projektvendimit. Për mëtejër që jemi në proces integrimi dhe aktet ligjore janë në procedura amendimi të vazhdueshme. Gjithashtu mund të kufizohet karakteri i përgjithshëm i listës.
	INCA, në cilësinë e operatorit të licencuar në fushën e grumbullimit, transportit, trajtimit dhe asgjësimit të nënprodukteve shtazore dhe	INCA	Refuzuar	Objekti i projektvendimit “Për miratimin e listës së veprimtarive që konsiderohe

	produkteve me origjinë shtazore të papërshtatshme për konsum human, u njoh me projektvendimin “Për miratimin e listës së veprimtarive që konsiderohen si të rrezikshme për mjedisin” dhe relacionin shoqërues të tij, të nxjerrë për konsultim publik. Vlerësojmë pozitivisht nismën për hartimin e këtij projektakti, i cili \n synon identifikimin e veprimtarive që paraqesin rrezik të lartë për shkaktimin e dëmit mjedisor, forcimin e mekanizmave të parandalimit dhe krijimin e një kuadri më të qartë për zbatimin e parimit “Ndotësi paguan”. \n krijon mundësinë që operatorët e sektorëve të ndryshëm të kontribuojnë me përvojën e tyre praktike në			n si të rrezikshme për mjedisin” nuk është të përcaktojë në detaje aktivitete, ashtu sic përcakton legjislacioni ne fuqi per vlerësimin e ndikimit në mjedis apo për lejet e mjedisit. Aktivitet e listuara në projektvend im janë të përgjithshm e dhe jo specifike, për këtë arsye nuk mund të veçohen specifikisht “thertoret”. Projektvend imi i referohet aktiviteteve që pajisen me leje mjedisi, aty ku përfshihet dhe
--	---	--	--	--

	identifikimin e problematikave që hasen gjatë zbatimit të legjislacionit mjedisor. Sugjerimet e paraqitura më poshtë bazohen në përvojën konkrete të krijuar gjatë ushtrimit të aktivitetit tonë dhe në problematikat e hasura ndër vite në menaxhimin e nënprodukteve shtazore, produkteve ushqimore të papërshtatshme për konsum human dhe ujërave të ndotura të gjeneruara nga aktivitetet e therjes dhe përpunimit të produkteve me origjinë shtazore. 1. Çmohet se përbën mungesë në projekt akt mos identifikimi i veçantë të veprimtarive që gjenerojnë nënprodukte shtazore dhe produkte ushqimore të papërshtatshme			aktiviteti “thertore” që ju keni kërkuar në shtojcën I të ligjit 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar.
--	--	--	--	---

	për konsum human Në shqyrtim të projektvendimit, vlerësojmë se formulimi aktual i listës së veprimtarive të rrezikshme për mjedisin mbështetet kryesisht në ekzistencën e lejeve mjedisore ose autorizimeve administrative për shkarkime, ndërkohë që neni 50 i ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, kërkon identifikimin e veprimtarive që për nga natyra e tyre paraqesin rrezik për shkaktimin e dëmit mjedisor, në funksion të parimit “Ndotësi paguan”, parandalimit të dëmit mjedisor dhe marrjes së masave parandaluese. Në këtë kuadër, vlerësojmë se lista e propozuar nuk adreson në mënyrë të mjaftueshme një kategori			
--	--	--	--	--

	veprimtarish që në praktikë paraqesin potencial të lartë për ndotjen e ujërave, tokës, ajrit dhe për krijimin e rrezikut biologjik, konkretisht: thertoret, stabilimentet e përpunimit të mishit, stabilimentet e përpunimit të peshkut, baxhot dhe stabilimentet e përpunimit të qumështit, frigoriferët dhe magazinat ushqimore dhe në tërësi operatorët që gjenerojnë nënprodukte shtazore dhe produkte ushqimore të papërshtatshme për konsum human. Këto veprimtari gjenerojnë në mënyrë të vazhdueshme nënprodukte shtazore, mbetje biologjike me potencial të lartë ndotës, ujëra të ndotura me ngarkesë të lartë			
--	--	--	--	--

	organike, materiale me rrezik për përhapjen e mikroorganizmave patogjenë dhe zoonozave. 2. Arsyeja për domosdoshmërinë e përfshirjes së këtyre veprimtarive në listën e veprimtarive të rrezikshme për mjedisin lidhet drejtpërdrejt me potencialin e tyre real për shkaktimin e dëmeve serioze mjedisore dhe sanitare. a. Në praktikë, masivisht nënproduktet shtazore dhe produkteve me origjinë shtazore të papërshtatshme për konsum human nuk i nënshtrohen grumbullimit dhe trajtimit të kontrolluar, por groposen, depozitohen në mënyrë të pakontrolluar ose përfundojnë në landfill. Vetë sasi të			
--	---	--	--	--

	krejt të kufizuara që rezultojnë të grumbulluara nga industria e përpunimit tregojnë se masivi i këtyre materialeve vazhdon të ‘menaxhohet’ jashtë sistemeve të kontrolluara. b. Ndryshe nga shumë kategori të tjera mbetjesh, nënproduktet shtazore paraqesin rrezik të veçantë për shëndetin publik dhe shëndetin e kafshëve. Për shkak të natyrës së tyre biologjike, ato shërbejnë si burim për përhapjen e sëmundjeve infektive dhe zoonozave, pasi ekspozohen ndaj brejtësve, kafshëve endacake dhe shpendëve të egër, të cilët veprojnë si vektorë të përhapjes së agjentëve patogjenë në mjedis. Ky rrezik është veçanërisht shqetësues në			
--	---	--	--	--

	kushtet e përhapjes së gjerë të këtyre praktikave në territor dhe të afërsisë së tyre me aktivitetet blegtorale dhe popullsinë. c. Këto materiale përmbajnë përqindje shumë të lartë lagështie, që arrin ose tejkalon 70% të masës së tyre. Për pasojë, groposja apo depozitimi i tyre në tokë krijon potencial të lartë për ndotjen e tokës dhe të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore përmes lëngjeve të ndotura që çlirohen gjatë dekompozimit. Në të njëjtën kohë, procesi i kalbëzimit shoqërohet me çlirimin e gazeve dhe përbërësve të tjerë ndotës me ndikim negativ në mjedis. Pikërisht për këtë arsye, legjislacioni veterinar dhe praktikat moderne të menaxhimit të mbetjeve			
--	--	--	--	--

	parashikojnë trajtimin e kontrolluar të tyre dhe jo depozitimin në mjedis. d. Edhe në rastet kur këto materiale depozitohen në landfill, veç problematikave të mësipërme, ër shkak të përmbajtjes së lartë të ujit dhe ngarkesës organike, ato rrisin ndjeshëm sasinë e lëngjeve të ndotura që duhet të trajtohen nga landfilli, duke shtuar kostot e menaxhimit dhe rrezikun e ndotjes së mjedisit. Gjithashtu, përzierja e tyre me flukse të tjera mbetjesh ndikon negativisht në cilësinë e këtyre flukseve dhe pengon proceset e rikuperimit apo riciklimit. e. Një problematikë e veçantë paraqitet edhe në sektorin e therjes dhe përpunimit të produkteve me			
--	--	--	--	--

	originë shtazore. Thertoret dhe stabilimentet e ngjashme janë të shpërndara në të gjithë territorin e vendit dhe gjenerojnë sasi të konsiderueshme ujërash të ndotura me ngarkesë të lartë organike, gjak, yndyrna dhe materiale të tjera biologjike. Shkarkimi i pakontrolluar ose i pamjaftueshëm i trajtuar i këtyre ujërave shkakton ndotje serioze të trupave ujorë, kanalizimeve dhe mjedisit në përgjithësi. 3. Një problematikë e veçantë lidhet me faktin se formulimi aktual i projektvendimit mbështetet kryesisht në regjimin e lejeve mjedisore. Një numër i konsiderueshëm thertoresh, baxhosh dhe stabilimentesh			
--	--	--	--	--

	përpunimi nuk i nënshtrohen detyrimit për pajisje me leje mjedisore të tipit A apo B për shkak të kapaciteteve të deklaruar apo pragjeve të përcaktuara nga legjislacioni sektorial. Kjo nuk do të thotë se ato nuk paraqesin rrezik mjedisor. Përkundrazi, pikërisht shpërndarja e tyre e gjerë në territor, mungesa e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura, menaxhimi masivisht i pakontrolluar i nënprodukteve shtazore dhe mungesa e sistemeve efektive të monitorimit i bëjnë këto veprimtari potencialisht ndër burimet më problematike të ndotjes së mjedisit. Për rrjedhojë, kufizimi i listës vetëm tek			
--	--	--	--	--

	veprimtaritë që identifikohen përmes regjimit të lejeve mjedisore rrezikon të lërë jashtë një kategori aktiviteteve që në praktikë paraqesin potencial të lartë për shkaktimin e dëmit mjedisor dhe që për këtë arsye duhet të identifikohen shprehimisht në kuptim të nenit 50 të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Për sa më sipër, sugjerojmë që lista e veprimtarive të rrezikshme për mjedisin të plotësohet me një kategori të posaçme me formulimin: \ Veprimtaritë që gjenerojnë nënprodukte shtazore, produkte me origjinë shtazore të papërshtatshme për konsum human, mbetje biologjike ose ujëra të ndotura me ngarkesë të			
--	---	--	--	--

	lartë organike, përfshirë veprimtaritë e therjes së kafshëve, përpunimit të mishit, peshkut, qumështit dhe produkteve të tjera me origjinë shtazore, pavarësisht nëse i nënshtrohen ose jo detyrimit për pajisje me leje mjedisore sipas legjislacionit në fuqi. Një shtesë e tillë do të ishte në përputhje me qëllimin e nenit 50 të ligjit nr. 10431/2011 për identifikimin e veprimtarive me potencial të lartë për shkaktimin e dëmit mjedisor, do të forconte karakterin parandalues të kuadrit ligjor dhe do t'u jepte autoriteteve kompetente një bazë më të qartë për monitorimin, kontrollin dhe			
--	---	--	--	--

	administrimin e rreziqeve mjedisore që burojnë nga këto veprimtari. Përmes këtij sugjerimi, i cili përputhet plotësisht me qëllimin e projektvendimit dhe të vetë ligjit nr. 10431/2011, nuk synojmë aspak ekspozimin e këtyre operatorëve ndaj masave shtesë kontrolli apo barrave administrative, por kemi një interes të ligjshëm për një vëmendje më të shtuar ndaj respektimit dhe zbatimit efektiv të kërkesave ligjore që rregullojnë menaxhimin e nënprodukteve shtazore dhe produkteve ushqimore të papërshtatshme për konsum human Vlerësojmë se një zbatim kërkesave ligjore do të kontribuonte në orientimin e sasive që sot groposen,			
--	--	--	--	--

	depozitohen në mënyrë të pakontrolluar ose përfundojnë në landfill drejt trajtimit, përpunimit dhe rikuperimit të kontrolluar. Në këtë mënyrë, materiale që aktualisht trajtohen si mbetje dhe përbëjnë burim ndotjeje për tokën, ujërat dhe mjedisin do të drejtoheshin drejt industrisë së përpunimit, duke u shndërruar në produkte dhe derivate me vlerë ekonomike dhe mjedisore, si fertilizantë organikë, biogaz, lëndë të para për industri të ndryshme dhe produkte të tjera të dobishme. Madje, në rastin e fertilizantëve organikë, kemi një shembull domethënës ku materiale që në gjendjen e tyre të papërpunuar përbëjnë burim ndotjeje për tokën,			
--	---	--	--	--

	pas përpunimit kontribuojnë pikërisht në pasurimin dhe përmirësimin e saj. Në këtë kuptim, zbatimi efektiv i kërkesave ligjore mundëson kalimin nga trajtimi i këtyre materialeve si mbetje drejt trajtimit të tyre si burime me vlerë për ekonominë dhe mjedisin. Për rrjedhojë, një identifikim më i qartë i këtyre veprimtarive si veprimtari me potencial të lartë për shkaktimin e dëmit mjedisor nuk do të sillte vetëm përfitime në aspektin e mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit publik, por do të krijonte gjithashtu kushte më të favorshme për zhvillimin e industrisë së trajtimit dhe rikuperimit të nënprodukteve shtazore, nxitjen e			
--	--	--	--	--

	investimeve në këtë sektor dhe rritjen e kapaciteteve kombëtare për menaxhimin e qëndrueshëm të këtyre materialeve.			
--	---	--	--	--